REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.___, datë___.___2026

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.153 DATË 23.12.2025 , LIDHUR ME NUMRIN E PUNONJËSVE TË NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9 pika c dhe ç, neni 54 germa ç dhe dh, ligji 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligji nr.68 datë 27.04.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore" , Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.153 datë 23.12.2025 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm" , Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndryshimin e pikës 1.3 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.153 datë 23.12.2025 duke shtuar 10 punonjës shërbimi të përhershëm dhe 20 punonjës sezonalë për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.
2. Efektet financiare të pikës 1 do të përballohen nga buxheti i vitit 2026 për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.
3. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore"dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë.

K R Y E T A R I
Oltion ÇAÇI
Me urdhër dhe delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RELACION MBI PROJEKT VENDIMIN

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.153 DATË 23.12.2025 , LIDHUR ME NUMRIN E PUNONJËSVE TË NDËRMARRJES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE"

Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak!

Ky projekt-vendim paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Sarandë, me qëllim ndryshimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, si një nevojë e domosdoshme për përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësive të shtuara të institucionit në administrimin dhe menaxhimin e shërbimeve publike në territorin e Bashkisë Sarandë.

Bashkia Sarandë, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ka ndërmarrë masa për përmirësimin e administrimit të hapësirave publike, rritjen e eficiencës së shërbimeve ndaj qytetarëve dhe garantimin e menaxhimit të rregullt të infrastrukturave publike me interes të përgjithshëm.

Në këtë kuadër, administrimi i terminalit të transportit dhe i parkimeve publike paraqet një nevojë të shtuar organizative dhe operative, e cila kërkon angazhim të burimeve njerëzore shtesë, me qëllim garantimin e funksionimit normal, monitorimit të vazhdueshëm, kontrollit të hyrje-daljeve, menaxhimit të fluksit të automjeteve dhe ofrimit të shërbimeve në standardet e kërkuara.

Rritja e fluksit turistik dhe e numrit të automjeteve, sidomos gjatë sezonit turistik, ka sjellë një ngarkesë të konsiderueshme në administrimin e parkimeve publike dhe të terminalit, duke bërë të domosdoshëm shtimin e strukturës së punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Kjo ndërhyrje synon jo vetëm përmirësimin e cilësisë së shërbimit, por edhe garantimin e rendit, sigurisë dhe administrimit efikas të këtyre hapësirave publike.

Për sa më sipër, propozohet ndryshimi i pikës 1.3 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.153, datë 23.12.2025, duke reflektuar shtimin e numrit të punonjësve në strukturën e Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, 10 punonjës të përhershem shërbimi dhe 20 punonjës sezonalë 3 mujor.

Efektet financiare që rrjedhin nga shtimi i numrit të punonjësve do të përballohen nga buxheti i miratuar i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe të ardhurat e krijuara nga administrimi i terminalit dhe parkimeve publike, në përputhje me planifikimet buxhetore dhe aktet financiare në fuqi.

Projekt-vendimi mbështetet në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe aktet nënligjore përkatëse për administrimin financiar dhe organizimin e strukturave të institucioneve të vetëqeverisjes vendore.

Për sa më sipër, kërkohet miratimi i këtij projekt-vendimi " *Për një ndryshim në vendimit të këshillit bashkiak nr.153 datë 23.12.2025 , lidhur me numrin e punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike".*

Znj. Garufo Koka

Drejtor, Drejtoria Juridike

Znj. Fotini Eksarho

Drejtor, Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Z. Rustem Duka

Drejtor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.___, datë___.___2026

"MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA TË ARDHURAT E BASHKISË PËR MUAJIN PRILL 2026"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë " , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr 3 date 29.01.2026" Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor për vitin 2026 "Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.153 datë 23.12.2025 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe mbeshtetje financiare nga të ardhurat e Bashkisë Sarandë për muajin Prill 2026 në total për Bashkinë Sarandë dhe Njesinë Administrative Ksamil 52 familje me një fond 216.839 *(dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë*) lekë dhe konkretisht:

Nr.	**Njësitë Administrative**	**Nr.i familjeve**	**Shuma në lekë**
1	Qendra e Bashkisë Sarandë	40	150.509
2	Njesia Administrative Ksamil	12	66.330

Familjet që do të përfitojnë në skemën e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Prill janë sipas listës bashkëlidhur.

Të mos trajtohen me ndihmë ekonomike familjet si më poshtë:

Qendra e Bashkisë Sarandë

Nr	**Emër Atësi Mbiemër**	**Arsyet e daljes nga skema**
1	Drita Rushit Saliaj	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE
2	Stavrulla Perikli Gaja	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE

Rifuten ne skemën e ndihmës ekonomike në Bashkinë Sarandë 8 familje:

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e hyrjes në skemë
1	Jorgjia Nestor Kozllorof	Kryefamiljare grua pensioniste me te ardhura te pamjaftueshme

2. Ngarkohen Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër dhe delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM
Nr.___, datë___.___2026

"PËR MIRATIMIN E VENDBAZIMEVE TË MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDET E LËVIZJES SË TYRE PËR BASHKINË SARANDË DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE KSAMIL "

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja b dhe nënpika 1.2, shkronja c, nenit 54, shkronja e/1, nenit 55, pikat 3 dhe 6, nenit 28, pika 2, te ligjit nr. 44/2015,"Kodi i Proçedurave Administrative i Republikes së Shqipërise", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" i ndryshuar neni 4 , Vendimit nr.2 datë 28.07.2020 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për përcaktimin e zonës me përparësi zhvillimin e turizmit detar dhe miratimin e hartës së aktiviteteve", pas shqyrtimit të materialit te përgatitur , Këshilli Bashkiak vendosi:

V E N D O S I:

1. Miratimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre për Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil, sipas materialit hartografik bashkëlidhur dhe pjesë përberëse të këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrja e Shërbimeve për zbatimin e keti vendimi.
3. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.26 datë 30.04.2024 "*Për miratimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridet e lëvizjes së tyre"*, shfuqizohet.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër dhe delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Elton DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

RELACION PËR PROJEKT- VENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E VENDBAZIMEVE TË MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDET E LËVIZJES SË TYRE PËR BASHKINË SARANDË DHE NJËSINË ADMINISTRATIVE KSAMIL ”

Të nderuar Këshilltar!

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Sarandë për administrimin dhe menaxhimin e territorit, garantimin e rendit dhe sigurisë publike, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit bregdetar, është paraqitur për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë nr. 26 datë 30.04.2024 “Për miratimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridoreve të lëvizjes së tyre””.

Ky projekt-vendim vjen si nevojë konkrete administrative, me qëllim përshtatjen e tyre me situatën aktuale në terren, organizimin më efikas të aktivitetit detar gjatë sezonit turistik, si dhe garantimin e standardeve të sigurisë për pushuesit dhe subjektet që ushtrojnë aktivitet me mjete lundruese për Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil.

Nisur sa më lartë Bashkia Sarandë në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024 “*Për miratimin e rregullores “për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”* neni 6 gërma dh , ku shprehimisht parashikohet se :

2. Për përcaktimin e vendqëndrimeve dhe korridoreve të lëvizjes, të përcaktuara në në shkronjën „ç“ , të pikës 1 të këtij vendimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjitshmë Detare dhe me strukturat e Policisë Kufitare si dhe me A gjencitë rajonale të Bregdetit.

Ka mbajtur koorespodencë me autoritetet përkatës përgjegjëse për sigurinë dhe kontrollin e hapësirës detare, konkretisht me Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, e cila me shkresën nr.604/1prot. datë 06.05.2026 në ushtrim të kompetencave të saj ka evidentuar domosdoshmërinë e përcaktimit dhe pasqyrimit të qartë të korridoreve të lëvizjes së mjeteve lundruese, me qëllim garantimin e sigurisë detare, kontrollit të qarkullimit të mjeteve lundruese, shmangien e situatave me risk për pushuesit dhe administrimin e rregullt të aktivitetit në zonat bregdetare, dhe për këtë ka sugjeruar që kooridoret ujore të lëizjes për Njësinë Administrative Ksamil të jene vetëm 2.

Nga ana tjeter Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Drejtoria Rajonale Sarandë me shkresën nr.188/1 datë 07.05.2026 , ka shprehur dakortësinë insitucionale me materialin e propozuar nga ana e Bashkisë Sarandë.

Për këtë qëllim , në kuadër të masave për mbarvajtjen e sezonit turistik 2026, me qëllim rritjen e sigurisë në det dhe me qëllim përmirësimin e të gjitha shërbimeve lidhur me subjektet tregtare që opërojnë në këtë fushë, po ju paraqesim materialin me vendbazimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre për Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil.

Për sa më lartë , shpresojmë në votimin e projekt vendimit *"Për miratimin e vendbazimeve të mjeteve lundruese dhe korridet e lëvizjes së tyre për Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil "* .

Znj. Garufo Koka

Drejtor, Drejtoria Juridike

Znj. Entela Çipa

Specialist jurist, Drejtoria Juridike

Z. Jolio Dine

Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Publike

Kër. Lorenca
13.05.2026

BASHKIA SARANDE
NR. 3482 Prot.
Date 12.05.2026

Bp. Shq Sarande
12.5.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
DEPARTAMENTI PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
DREJTORIA VENDORE PËR KUFIRIN DHE MIGRACIONIN
KOMISARIATI I POLICISË KUFITARE

Nr. 604/1 Prot.

Sarandë, më 6.05.2026

Lënda: Kthim përgjigje shkresës nr.3035 datë 28.04.2026

Drejtuar :

BASHKISË SARANDË

Sarandë

Për dijeni:

DREJTORISË TË PËRGJITHËSHME DETARE
KAPITENERISË TË PORTIT

Sarandë

ANGJENSISë RAJONALE Të BREGDETIT

Sarandë

Në përgjigje të shkresës Tuaj me nr.3035 datë 28.04.2026, protokolluar nga ana jonë me nr.604 datë 04.05.2026, ju informojmë se:

Me shkresën tonë me nr.429 datë 01.04.2026, "Kërkësë për bashkëpunim, për marrjen e masave për menaxhimin e Sezonit Turistik Veror 2026", kemi sugjeruar duke u nisur nga eksperienca e vitit 2025, ku ishin miratuar vetëm për Ksamilin **12 korridore** për hyrje-daljen e mjeteve lundruese turistike, që korridoret e hyrje-daljeve të motorrave të ujit, të parashikohen dhe vendosen jashtë plazheve, në ekstremet e tyre dhe ku nuk ka lëvizje të shtetasve dhe **për Ksamilin kemi sugjeruar 2 korridore** për hyrje-daljen e mjeteve lundruese turistike.

Përsa më sipër në lidhje me propozimin e përgatitur nga ana juaj dhe i shoqëruar dhe me hartat përkatëse, jemi pjesërisht dakort.

Komisariati i Policisë Kufitare Sarandë ju falenderon për bashkepunimin Tuaj dhe për marrjen në konsideratë të sugjerimeve tona.

Duke Ju falenderuar për vëmëndjen.

SHEFI I KOMISARIATIT
Komisar Elvid SHEHU

Adresa: Rruga " Mit'hat Hoxha ", Sarandë – Shqipëri; Cel: 00355 694110257 e-mail: adresa krkmsarandë@asp.gov.al

Per Conson
12.05.2026

BASHKIA SARANDE
NR. 3396 Prot.
Date 08.05.2026

Sv. Shabani
11.05.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT
AGJENCIA RAJONALE E BREGDETIT SARANDË

Nr. 188/1 Prot.

Sarandë, më 07 . 05 .2026

Lënda: *Kthim përgjigje mbi hartën e propozuar lidhur me korridoret e levizjes së mjeteve ujore*

Drejtuar: **BASHKISË SARANDË**

Sarandë

Për dijeni: **AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT**

Tiranë

Të nderuar,

Agjencia Rajonale e Bregdetit Sarandë, në zbatim të Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 649, datë 16.10.2024, *Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit, të ndryshuar,* në përgjigje të propozimit tuaj nr. 3035 prot, datë 28.04.2026, protokolluar pranë ARB Sarandë, me nr. 188 prot, datë 04.05.2026, Ju bën me dije si më poshtë vijon:

Në përgjigje të shkresës suaj lidhur me hartën e propozuar për korridoret e lëvizjes së mjeteve ujore në Njësinë Administrative Ksamil, ju bëjmë me dije se institucioni ynë, Agjencia Rajonale e Bregdetit Sarandë, pasi u njoh me materialin e paraqitur, shpreh dakordësinë institucionale mbi propozimin në fjalë.

Duke ju falenderuar përbashkëpunimin.


DREJTORI

ASTRIT BILIBASHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA RAJONALE E BREGDETIT
SARANDË
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT

HARTA E PËRGJITHSHME PËR:VENDQËNDRIMET E MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE

SHKALLA 1:2500



VITI 2026

BASHKIA SARANDË

OBJEKTI


KORIDORET DHE ZONAT E ANKORIMIT PËR MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE

EMËRTIMI I FLETËS

BASHKIA SARANDË

HARTA E PËRGJITHSHME PËR:VENDQËNDRIMET E MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE

SHKALLA 1:2500



VITI 2026

BASHKIA


SARANDË

OBJEKTI	KORIDORET DHE ZONAT E ANKORIMIT PËR MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE
EMËRTIMI I FLETËS	BASHKIA SARANDË

Hart
Hart
Hart

HARTA E PËRGJITHSHME PËR:VENDQËNDRIMET E MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE


SHKALLA 1:2500



VITI 2026	BASHKIA SARANDË	**OBJEKTI**: KORIDORET DHE ZONAT E ANKORIMIT PËR MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE
		EMËRTIMI I FLETËS: BASHKIA SARANDË

HARTA E PËRGJITHSHME PËR:VENDQËNDRIMET E MJETEVE LUNDRUE[illegible] DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE

SHKALLA 1:2500



VITI 2026

BASHKIA SARANDË

OBJEKTI

EMËRTIMI I FLETËS

KORIDORET DHE ZONAT E ANKORIMIT PËR MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE

BASHKIA SARANDË


Harto

Harto

Harto

HARTA E PËRGJITHSHME PËR:VENDQËNDRIMET E MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE

SHKALLA 1:2500



VITI 2026

BASHKIA SARANDË

OBJEKTI	KORIDORET DHE ZONAT E ANKORIMIT PËR MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE
EMËRTIMI I FLETËS	BASHKIA SARANDË

Hartoi	IN
Hartoi	IN
Hartoi	IN

HARTA E PËRGJITHSHME PËR:VENDQËNDRIMET E MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE


SHKALLA 1:2500



BASHKIA SARANDË	OBJEKTI	KORIDORET DHE ZONAT E ANKORIMIT PËR MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE	Har
	EMËRTIMI I FLETËS		Har
VITI 2026		BASHKIA SARANDË	Har

HARTA E PËRGJITHSHME PËR:VENDQËNDRIMET E MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE

SHKALLA 1:2500



VITI 2026	BASHKIA SARANDË	**OBJEKTI**	KORIDORET DHE ZONAT E ANKORIMIT PËR MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE
		EMËRTIMI I FLETËS	BASHKIA SARANDË

HARTA E PËRGJITHSHME PËR:VENDQËNDRIMET E MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE


SHKALLA 1:2500



VITI 2026	BASHKIA SARANDË	OBJEKTI	KORIDORET DHE ZONAT E ANKORIMIT PËR MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE
		EMËRTIMI I FLETËS	BASHKIA SARANDË

HARTA E PËRGJITHSHME PËR:VENDQËNDRIMET E MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE


SHKALLA 1:2500



VITI 2026	BASHKIA SARANDË	OBJEKTI: KORIDORET DHE ZONAT E ANKORIMIT PËR MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE
		EMËRTIMI I FLETËS: BASHKIA SARANDË
		Hart
		Hart
		Hart

HARTA E PËRGJITHSHME PËR:VENDQËNDRIMET E MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE

SHKALLA 1:2500




BASHKIA SARANDË	**OBJEKTI**	KORIDORET DHE ZONAT E ANKORIMIT PËR MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE
	EMËRTIMI I FLETËS	BASHKIA SARANDË

VITI 2026

HARTA E PËRGJITHSHME PËR:VENDQËNDRIMET E MJETEVE LUNDRUESE DHE KORRIDORET E LËVIZJES SË TYRE

SHKALLA 1:2500



VITI 2026	BASHKIA SARANDË	OBJEKTI	KORIDORET DHE ZONAT E ANKORIMIT PËR MJETET LUNDRUESE ARGËTUESE
		EMËRTIMI I FLETËS	BASHKIA SARANDË

Hart
Hart
Hart

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.___, datë___.___2026

"PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.135 DATË 27.10.2023 "PËR PËRCAKTIMIN E DISA KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSET PËR TO NË TERRITORIN E BASHKISË SARANDË"

Në mbështetje të ligjit 44/2015 " Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar , Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.325 datë 19.03.2008 "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e subjektit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve , si dhe njohjen e dokumentave zyrtare , të caktuara për këta subjekte" I ndryshuar, Udhëzimi nr. 5627 datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", Udhëzimin nr.15 datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimarisë në transportin rrugor" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.20 datë 16.06.2017 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së trasportit taksi të udhëtarëve" ndryshuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.135 datë 27.10.2023 **"**Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Sarandë" , pas shqyrtimit të relaconit, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në vendimin nr.135 datë 27.10.2023 **"***Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Sarandë" ,* si më poshtë vijon:

Në nenin 8 ku parashikohen "*Zënia në kundërshtim me rregullat të hapësirës publike"* të shtohet pika 2.1 si më poshtë:

2.1 *Do të konsiderohen shkelje së rregullave të zënies së hapësirës publike:*

a. Ushtrimi i aktivitetit në një hapësirë më të madhe se ajo e përcaktuar në lejen që i është dhënë;
b. Instalimi i pajisjeve për të cilat nuk ka marrë lejen përkatëse;
c. Kur mosmirëmbajtja e pajisjeve dëmton/cenon dekorin e qytetit ose përbën rrezik për jetën e qytetarëve;
d. Subjekti nuk mban pastër hapësirën e cila i është lënë në dispozicion;
e. Subjekti i pajisur me autorizim prish qetësinë publike apo ka sjellje të padenjë në hapësirën e dhënë për shqfrytëzim;
f. Vazhdimi i aktivitetit edhe pas mbarimit të afatit të përcaktuar në leje apo anulimit;
g. Kur zënia e kryer nuk është në përputhje me kriteret që janë përcaktuar në lejen e dhënë si edhe;
h. Zënia e hapërirës publike dhe bllokimin e rrugës nga mjete të tonazhit të rëndë pa autorizimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

Në nenin ku parashikohen "*Kundravajtjet administrative në fushën e sigurisë*" të riformulhet pika n si më poshtë:

n. *Zënia e vënd parikimeve publike dhe vendeve ku lejohet parikim në hapësirat pranë blloqet e banesave, ose trotuare/çdo hapësirë të përbashëet, me automjete me qëllim ekspozimi/tregimi i tyre apo qëllim biznesi të tjera , si dhe motora , biçikleta , monopatina për qëllime ekspozimi ose tregtimi*

Pika o në nenin ku parashikohen "*Kundravajtjet administrative në fushën e sigurisë*" të riformulohet si më poshtë:

o. *Qarkullimi me mjete motorike , biçikleta, monopatina etj të ngjashme me to , në shëtitore , parqe apo vende pushimi për qytetarët sipas rregullave të përcaktuara nga Bashkia Sarandë dhe strukturat përgjegjesë të saj.*

Në rastin kur nga ana e strukturës konstatuese , evidentohet drejtimi i tyre nga ana e minorenëve , do të duhet përtej procedurës administrative të gjobës , të vendos masë të përkohshme për sekuestrimin e tyre dhe ruajtjen në vendin e përcaktuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë.

Në nenin 12 ku parashikohen "*Kundërvajtjet administrative në fushën e infrastrukturës publike*" të shtohet pika 4 si më poshtë:

4. *Dëmtimi i sinjalistikës rrugore:*
a. dëmtimi i sinjalistikës vertikale

b. dëmtimi i koneve sinjalizues
c. dëmtim të sinjalistikës horizontale(polic i shtrirë etj)

Të shtohet pika 5 me përmbajtjen si më poshtë:

5. *Braktisja e punimeve dhe mosrikthimi në gjendjen e mëparshme të hapësirës publike trotuar rrugë etj, nga subjekte të kompanive të komunikimeve elektronike, si interneti telefonisë etj , përtej masës administrative , procedura do të duhet të vendoset dhe shpërblimi i dëmit të hapësirës publike.*

Neni 14 "*Masat parandaluese për kundërvajtjet administrative*" të riformulohet si më poshtë:
Përveç sanksionit administrativ të vendosur nga strukturat konstatuese për secilën nga kundërvajtjet e parashikuara në këtë vendim, kundërvajtësit i nënshtrohen edhe masës së sekuestrimit ose konfiskimit të sendeve/mallrave që kanë shërbyer apo që ishin caktuar për të shërbyer si mjete për kryerjen e kundërvajtjes administrative të parashikuara në këtë vendim, të cilat do të ruhen në vendin e përcaktuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Sarandë

Të shtohet neni 18/1 "*Shpërblimi i dëmit dhe përllogaritja e tij"* me përmbajten si më poshtë:

1. *Nëse struktura konstatuese, konstaton shkaktim dëmi që vjen si pasoj e kundërvajtjes administrative, menjëherë pas vendosjes së gjobës për kundërvajtjen administrative, njofton strukturën përkatëse që është përgjegjëse për përllogaritjen e dëmit të shkaktuar dhe dëmshpërblimin e tij.*

2. Struktura përgjegjëse vlerëson masën e dëmit dhe me një akt administrativ më vete vendos masën dhe mënyrën e shpërblimin të dëmit.

3. Shpërblimi i dëmit kryhet nëpërmjet zëvendësimit apo kthimit në gjendjen e mëparshme të pronës publike, sendit/objektit/hapësirës së dëmtuar ose duke paguar kundërvleftën monetare të dëmit të shkaktuar.

4. Përllogaritja e dëmit të kryhet sipas kësaj formule:
Dm = TSDm x KRb
TSDm = totali i sendeve të dëmtuara;
KRb = kosto për kthimin në gjendjen e mëparshme të sendit

5. Struktura përgjegjëse për shqyrtimin përllogaritjen e dëmit është Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Policia Bashkiake, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

RELACION PËR PROJEKT-VENDIMIN
"PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.135 DATË 27.10.2023 "PËR
PËRCAKTIMIN E DISA KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONIN QË VENDOSET PËR TO NË TERRITORIN E BASHKISË SARANDË

Të nderuar Anëtare të Këshillit Bashkiak!

Ky projekt-vendim paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Sarandë, në kuadër të nevojës për përmirësimin, plotësimin dhe forcimin e mekanizmave administrativë që lidhen me garantimin e rendit publik, administrimin e hapësirave publike, mbrojtjen e infrastrukturës publike dhe rritjen e eficiencës së strukturave përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e akteve administrative në territorin e Bashkisë Sarandë.

Gjatë zbatimit praktik të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.135 datë 27.10.2023, strukturat administrative të Bashkisë Sarandë, veçanërisht Policia Bashkiake, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe strukturat e kontrollit në terren, kanë evidentuar një sërë problematikash të përsëritura që lidhen me zënien e hapësirave publike në kundërshtim me kushtet e lejeve të dhëna, dëmtimin e elementëve të infrastrukturës publike dhe mungesën e mekanizmave të qartë për kompensimin e dëmeve të shkaktuara ndaj pasurisë publike.

Në praktikën administrative është konstatuar se subjekte të ndryshme ushtrojnë aktivitet përtej sipërfaqeve të miratuara në lejet përkatëse, vendosin pajisje apo struktura pa autorizim, nuk respektojnë kushtet e mirëmbajtjes së hapësirave të dhëna në përdorim, vijojnë aktivitetin edhe pas përfundimit të afatit të autorizimit apo krijojnë pengesa për qarkullimin dhe funksionimin normal të hapësirave publike. Këto situata kanë sjellë cenim të interesit publik, dëmtim të estetikës urbane, pengim të lëvizjes së qytetarëve dhe mjeteve, si dhe rëndim të barrës administrative për rikthimin e hapësirave në gjendjen e mëparshme.

Po ashtu, është evidentuar nevoja për të parashikuar në mënyrë më të detajuar kundërvajtjet që lidhen me dëmtimin e sinjalistikës rrugore, konëve sinjalizuese dhe elementëve të tjerë të infrastrukturës publike, të cilat përbëjnë elementë të rëndësishëm për sigurinë rrugore dhe administrimin normal të territorit.

Për këtë arsye, përmes këtij projekt-vendimi propozohet plotësimi i nenit 8 të vendimit ekzistues, duke përcaktuar në mënyrë më të qartë rastet që konsiderohen shkelje të rregullave të zënies së hapësirës publike, si:

- ushtrimi i aktivitetit përtej sipërfaqes së autorizuar;
- instalimi i pajisjeve pa leje;
- mosmirëmbajtja e pajisjeve apo hapësirës së dhënë në përdorim;
- cenimi i qetësisë publike;
- vazhdimi i aktivitetit pas mbarimit apo anulimit të lejes;
- bllokimi i rrugëve apo hapësirave publike pa autorizim përkatës.

Këto shtesa synojnë të krijojnë një bazë më të plotë ligjore për ndërhyrjen e strukturave konstatuese dhe për marrjen e masave administrative në raste konkrete shkeljesh.

